



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**PROJEKTI FITUES ME TITULL:**

**“ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS NË SHËRBBIM  
TË FUQIZIMIT TË KËRKUESËVE TË RINJ  
DHE TË STUDENTËVE”**

**FINANCUAR NGA MINISTERIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR  
VITIN AKADEMIK 2022-2023**



**Ekipi i projektit:**

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA (koordinatore)

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI

Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI

Prof. Asoc. Dr. Etleva KONDI

Dr. Elvana SHTËPANI

---

## REZULTATE DHE PËRFUNDIME

### 1. Objektivat dhe rezultatet kryesore të arritura

Objektivat kryesore të projektit janë realizuar: së pari me ngritjen e tre laboratorëve bashkëkohore të mësimdhënies me teknologji dhe së dyti që këto ambiente po përdoren për trajnime të vazhduara për mësuesit, përkthyesit, ndërmjetësit kulturorë dhe stafit të UT-së që dëshirojnë të përditësojnë dijet e tyre në fushat përkatëse.

Realizmi i këtij projekti është në përputhje me strategjinë sektoriale të Arsimit të Lartë (Strategjia kombëtare e arsimit 2021-2026, pika 4.4.5 për Shërbimet Digjitale). Duke qënë se shërbimet digjitale për studentët janë të kufizuara për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme, këta laborator kanë sjellë një hov të ri në procesin e mësimdhënies dhe nxënies nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja si dhe duke u dhënë mundësi kërkuesve të rinj shkencor të hulumtojnë për të dhëna shkencore si edhe duke i ndarë ato me kolegët e tyre, duke shkëmbyer ekspertizë e motivim për kërkime të reja me natyrë shkencore inovative.

Në përputhje me “Kuadrin Evropian për Kompetencën Digjitale” universiteti po tregon vazhdimisht përgjegjësinë e tij duke përgatitur të rinjtë mjaftueshëm për sfidat dhe mundësitë e një ekonomie të globalizuar duke u ofruar atyre mundësinë e zhvillimit të kompetencës digjitale të një niveli të avancuar. Përgatitja e studentëve të të tre cikleve të studimit është plotësuar me hapësirën digjitale të nevojshme me qëllim përballjen me sfidat aktuale të arsimit të lartë të lidhura kryesisht të lidhura me periudhën “post-covid”

Tri hapësirat e digjitalizuara krijuar për kërkuesit shkencorë, u ofrojnë atyre teknologjinë më të fundit në shërbim të palëve të interesuara dhe gjithashtu janë vendosur edhe në shërbim të stafit dhe studentëve të huaj që vijnë nëpërmjet programeve të ndryshme të shkëmbimit.

### 2. Rekomandime

Njohuritë e marra gjatë aktiviteteve të projektit shërbyen si bazë për të dhënë përfundime dhe rekomandime në disa nivele.

Laboratorët e teknologjisë luajnë një rol kyç në avancimin e mësimit të gjuhëve të huaja në zhvillimin e sotëm arsimor, duke u ofruar studentëve një mjedis dinamik dhe gjithëpërfshirës ku ata mund të shfrytëzojnë fuqinë e teknologjisë për të rritur aftësinë e tyre gjuhësore. Nëpërmjet aksesit në software-t e mësimit të gjuhëve të huaja, burimet multimediale, ushtrimet ndërvepruese dhe platformat e komunikimit virtual, studentët mund të angazhohen me gjuhët e huaja në mënyra të shumëanshme.

Në një epokë ku teknologjia është pjesë integrale e jetës së përditshme, laboratorët teknologjikë janë mjete të domosdoshme për pajisjen e studentëve me aftësitë gjuhësore dhe kompetencën kulturore të nevojshme për komunikim efektiv në një qytetari globale.

Për të siguruar një tranzicion të pandërprerë nga arsimit parauniversitar në arsimin e lartë, është e domosdoshme rritja e aftësive teknologjike të nxënësve parauniversitarë, veçanërisht në kontekstin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja.

Shkollat e arsimit parauniversitar duhet të kenë prioritet integrimin e teknologjisë në kurrikulën lëndore që në moshë të re. Për më tepër, shkollat duhet t'i inkurajojnë nxënësit të angazhohen me aplikacionet e mësimin të gjuhëve të huaja dhe burimet e gjuhës në internet, duke i bërë ata të aftë në navigimin e materialeve gjuhësore dixhitale dhe gjithashtu, mësuesit duhet të inkurajohen të luajnë një rol më aktiv në forcimin, zhvillimin dhe drejtimin e aftësive dixhitale dhe tek të nxënës bashkëpunues midis nxënësve të tyre.

### **3. Përfundime**

Sot Inteligjenca Artificiale (AI) është bërë një pjesë integrale e zhvillimeve të arsimit dhe ndërkohë që teknologjia përparon me një ritëm të shpejtë, mësimdhënësit po njohin gjithnjë e më shumë potencialin e AI për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhëve të huaja. Për më tepër, mjetet e përkthimit të fuqizuara nga AI ndihmojnë në thyerjen e barrierave gjuhësore, duke nxitur komunikimin global dhe shkëmbimin kulturor.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, me aftësinë e tij për të qënë gjithnjë avangard në edukimin gjuhësor, në strategjinë e tij synon të kthejë fokusin në zhvillimin e inteligjencës artificiale duke premtuar perspektiva emocionuese si për studentët ashtu edhe për pedagogët.

Nëpërmjet mbështetjes së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, fakulteti ynë ka qënë në gjendje të angazhohet me sukses në promovimin e integritetit evropian në fushën e arsimit të gjuhëve të huaja dhe në nisma kuptimplote, projekte bashkëpunimi dhe programe arsimore, që jo vetëm pasurojnë aftësitë gjuhësore të studentëve tanë, por gjithashtu rrënjosin një vlerësim të thellë për kulturat dhe gjuhët e ndryshme të Evropës. Kjo mbështetje ka forcuar padyshim lidhjet e unitetit, tolerancës dhe mirëkuptimit mes studentëve tanë, duke hedhur themelet për një të ardhme evropiane më të ndritshme dhe më harmonike.